

**BUJAR BENDO****EKSPERT KONTABËL I AUTORIZUAR**

Kodi fiskal 2301440

Lic Profesionale 079

Tiranë, më 10.7 2006.**RAPORT I BASHKIMIT**

Në zbatim të misionit të caktuar nga Asamblea e ortakëve me datë 10.7.2006\_ për vlerësimin e aktiveve të shoqërisë SELEN-ME shpk që kalojnë në shoqërinë DIMESIONE TE REJA shpk me rastin e bashkimit me thithje në këtë të fundit, unë Bujar Bendo, Ekspert Kontabël i Autorizuar paraqes Raportin tim si më poshtë:

**a) Shoqëritë pjesëmarrëse në bashkimin me thithje janë:****1. Shoqëria SELEN-ME shpk, shoqëria e përthithu.:**

- Forma juridike: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- Emërtimi: "SELEN-ME" shpk.
- Selia legale: Rruga "Xhevdet Nepravishta Nr 2" Lushnjes.
- Regjistruar në regjistrin tregtar me Vendimin e gjykatës nr 27942 datë 21.06.2002.
- NIPT K24310401 T
- Zotëruar 100% nga Ortakja e vetme Lindita Gjermani.
- Që zhvillon aktivitetin e saj kryesisht në fushën e tregëtimit të artikujve industriale import eksport.

**2. Shoqëria DIMESIONE TE REJA shpk, shoqëria përthithëse:**

- Forma juridike: "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar".
- Emërtimi: DIMESIONE TE REJA shpk
- Selia legale: Rruga "Kongresi i Lushnjes",
- Regjistruar në regjistrin tregtar, me Vendimin e Gjykatës nr 16741 datë 22.01.1997.
- NIPT J 64520413 J
- Zotëruar 100 % nga ortaku i vetem Edmond Gjermani .
- Që zhvillon aktivitetin në fushën e e tregëtimit të artikujve industriale import eksport.

**b) Vlerësimi i aktivitet dhe pasivitet të shoqërisë "SELEN-ME" sh.p.k , që i kalon shoqërisë përthithëse DIMESIONE TE REJA shpk.**

Kalimi i aktiveve e pasiveve të shoqërisë SELEN-ME shpk në bilancin e shoqërisë DIMESIONE TE REJA shpk bëhet sipas gjendjes së tyre me datën 31.12.2005.

Për vlerësimin e aktiveve e pasiveve të shoqërisë SELEN-ME shpk janë përdorur kriteret e përcaktuara në Ligjin nr 7661 datë 19.1.1993 për Kontabilitetin, nenet 59 deri 70, dhe në Planin Kontabël të Përgjithshëm, Kapitulli III Rregullat e vlerësimit:



- Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara: me koston e marrjes të pak suar me amortizimet sipas normave fiskale.
- Të drejtat mbi të tretët: me vlerat nominale sipas kontabilitetit.
- Detyrimet: me vlerat nominale sipas kontabilitetit.

• **Gjendja e vlerësimi i aktiveve dhe pasiveve :**

Shumat e kolones “ Ushtrimi I mbyllur “ rezultojne ne rregull si per aktivin ashtu edhe per pasivin e bilancit, te cilat kane shumen totale prej 17.450.852 leke

U kontrolluan grupet, rubrikat dhe postet per kolonat e ushtrimit te mbyllur, duke I verifikuar me saldote e llogarive dhe rezulton si me poshte vijon:

**AKTIVI**

Ne grupin B – “ **AKTIVE QENDRUESHME** “ shoqeria juaj me date 31 Dhjetor 2005 ka pasur gjendje 1.653.750 leke e cila perfaqson vleren neto te tyre te vleresuar me kosto historike, ne menyre analitike ky grup perbehet nga :

**II – TE TRUPEZUARA**

Per nje vlere prej 1.653.750 leke, e cila ne krahasim me vitin e kaluar ka ulje, analikisht ato perbehen:

B) Posti “ **Instalime teknike, makineri dhe pajisje**” per vleren bruto 2.362.500 leke I cili nuk ka ndryshim nga viti I kaluar . Nga verifikimi rezulton se te gjitha tepricat e levizjet e kryera jane te rakorduara me inventarin kontabel.

D) Posti “ **Amortizime** “ paraqet llogaritjen e amortizimit te aktiveve te qendrueshme per vleren 708.750 leke. Vlen te theksohet se amortizimi eshte llogaritur sipas rregullave ne fuqi dhe eshte brenda normave fiskale.Shuma e llogaritur me vlefte 236.250 leke eshte kaluar ne shpenzimet evitit ushtrimor.

**Grupi C – AKTIVE QARKULLUESE**

Shoqeria juaj me date 31 Dhjetor 2005 ka pasur ne dispozicion nje shume prej 15.570.460 leke , ne krahasim me vitin e kaluar ka ulje, te cilat sipas rubrikave jane ndare :

I – “ **Gjendje te inventarit dhe ne proces** “ per vleren 14.441.900 leke , vlen te theksohet se eshte ndjekur vleresimi me cmimin e blerjes e cila perbehet nga :

G) Posti “ **Produkte dhe mallra** “ per vleren prej 14.441.900 leke per te cilen ekziston edhe inventari kontabel I rakorduar .

Ne lidhje me me sasine fizike ne dt 31.12.2005 te mallrave nuk mund te japim vleresime per vete kohen e marjes se misionit dhe kohen qe kemi ne dispozicion per kryerjen e ketij misioni

II- “ **Kerkesa per arketim mbi debitoret** “ per nje vlere 1.128.560 leke qe perbehet nga

J) Posti “ **Te tjera kerkesa** “ me vlefte 1.128.560 leke e cila eshte e rakorduar , perkatesishit me llogarine 444 “tatim fitimi” I derdhur teper me vlefte 808.394 leke , me llogarine 445 “TVSH e zbritshme “me vlefte 320.166 leke ,e cila eshte e rakorduar me tepricen sipas FDP.

IV – **“Likuiditete dhe vlera te tjera ne arke”** per vleren prej 226.642 leke e cila I perket :

A) Posti (a) “ Depozita ne banke dhe llogari te tjera “ per nje vlere prej 77.564 leke dhe perfaqson gjendjen e bankes me 31.12.2005 sipas ekstrakteve.

B) Posti (b) “ Arka “ per vleren sipas librit te arkës me date 31 dhjetor per nje shume prej 149.078 leke .

#### PASIVI

Ne pasivin e bilancit paraqiten gjendja e llogarive te kapitali te shoqerise dhe ajo e detyrimeve te saj, te cilat jepen si me poshte :

**Grupi A – “ KAPITALE TE VETA “ ka nje vlere prej 7.595.158 leke e cila e ndare s ipas rubrikave paraqitet:**

I – **“ Kapitali themeltar, rezervat, fitime dhe humbje “** per vleren 9.957.658 leke e cila sipas posteve paraqitet :

A) Posti (a) “ Kapitali nenshkruar “ per vleren fillestare 100.000 leke I cili nga viti I kaluar nuk ka ndryshime

B) Posti (e) “Fitime e humbje te mbartura“ per vleren e 6.191.181 leke

C) Posti (h) “ Fitime e Humbje e Ushtrimit “ per nje vlere prej 1.303.977 leke e cila perfaqson fitimin e ushtrimit.

**Grupi B – “ DETYRIME “** ka nje vlere prej 9.855.694 leke e cila perbehet :

I II – **“ Detyrimet te kerkueshme pas me shume se ne nje vit “** per vleren 2.362.500 leke, e cila ka si vleresim shomene e financimine te ortakeve.

II – **“ Detyrimet te kerkueshme deri ne nje vit “** per vleren 7.493.194 leke dhe perbehet nga postet e meposhtme:

F) Posti “ Furnitore per sherbime dhe blerje “ per vleren 7.246.611 leke, e cila eshte e analizuar.

H) Posti “ Sigurime shoqerore “ per vleren e muajit dhjetor si detyrim ndaj deges se sigurimeve shoqerore(tatime) per 16.690 leke .

K) Posti “ Ortake“ per vleren e detyrimeve per nje shume 229.893 leke , e cila perfaqeson detyrimin qe ka shoqeria per financimet e ortakut.

Pasi verifikova postet e ketyre llogarive arrita ne konkluzionin qe te dhenat e marre nga bilanci verifikues jane te vleresuar dhe perbejen bazen per kalimin e tyre ne shoqerine Dimesione te Reja sh.p.k Lushnje

<b>Totali i pasiveve ( A+B)</b>	<b>17.450.852 lekë</b>
---------------------------------	------------------------

Për të gjitha llogaritë sintetike të të drejtave e detyrimeve disponohen analizat përkatëse të verifikuara e rakorduara.

**ç) Mënyra e dorzimit të pjesëve të kapitalit themeltar dhe data pas së cilës këto pjesë japin të drejta-pjesëmarrjeje.**

Me hyrjen në fuqi të bashkimit me thithje të gjitha detyrimet dhe të drejtat e shoqërisë SELEN -ME shpk ndaj të tretëve i merr përsipër shoqëria DIMESIONE TE REJA shpk. Gjithashtu të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kapitali për pjesëmarrje në fitimet e shoqërisë DIMESIONE TE REJA shpk pas bashkimit i takojnë ortakëve të kësaj shoqërie.

Në aspektin e kontabilitetit, data pas së cilës operacionet e shoqërisë së përthithur SELEN -ME shpk dhe asaj përthithëse DIMESIONE TE REJA shpk do të konsiderohen të kryera është 31.12.2005.

**d) Data e hartimit të llogarive.**

Për formulimin e kushteve të operacionit të bashkimit me thithje të shoqërisë SELEN-ME shpk në shoqërinë DIMESIONE TE REJA shpk, llogaritë janë hartuar për datën 31.12.2005.

**dh) Raporti i këmbimit të të drejtave në shoqëri.**

Meqenë se nga bashkimi me thithje kemi ndryshim të pronësisë, ortakët nuk mbeten të njëjtë, pasi nga bashkimi shoqëria SELEN-ME shpk zotërohet tërësisht nga shoqëria -DIMESIONE TE REJA shpk, në këtë rast ka vend për raporte këmbimi e për llogaritje shumash për të kompesuar pabarazinë e të drejtave të këmbyerë. Ortaku i shoqërisë **DIMESIONE TE REJA** shpk. Z. Edmond Gjermani është zoterues i 100 % të aksioneve të Selen ME sh.p.k me kapital fillestar 100.000 leke dhe nga bashkimi kapitali themeltar i shoqërisë perthithëse rezulton të jetë 200.000 leke.

**ë) Të drejta e avantazhe të veçanta**

Mbështetur në nenin 246 të Ligjit nr 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", data e hyrjes në fuqi të bashkimit do të jetë data e fundit e vitit financiar 2005, pra data 31.12.2005. Për efekte kontabile, për vitin financiar 2005 të dy shoqëritë ekzistuese, DIMESIONE TE REJA shpk e SELEN-ME shpk, do të përgatisin bilance të veçanta, dhe këto do të bashkohen në një bilanc të vetëm, i cili do të jetë edhe bilanci zyrtar i shoqërisë DIMESIONE TE REJA shpk. Për qëllime fiskale për vitin 2005 të dy shoqëritë, Dimesione te Reja e SELEN-ME shpk, do të paraqesin bilancet e tyre në organet tatimore. Gjithashtu do të paraqitet edhe bilanci i bashkimit i datës 31.12.2005, i cili do të jetë edhe bilanc i fillimit të vitit financiar e fiskal 2006 për shoqërinë DIMESIONE TE REJA shpk.

Për sa më lart, nga vlerësimet e aktiveve e pasiveve të shoqërisë SELEN-ME konkludojmë se ato janë konformë legjislacionit në fuqi.

*z.Bujar BENDO*

**EKSPEERT KONTABEL I Autorizuar**  
**BUJAR BENDO**  
Tel. \_\_\_\_\_